



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Kuvendi i Kryeqytetit**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2023, mbajtur më 10.08.2022, i cili filloi në orën 14:00.**

Në dëgjimin publik morën pjesë: **Myrvete Sopi-Dibrani, Arbër Vokrri, Bujar Gashi, Fatlinda Hoxha, Gjylje Sherifi, Arzije Krasniqi, Rrezart Hasimi, Florie Hyseni-Morina dhe Lorentë Alija.**

Morën pjesë edhe: **Valbona Makolli**, drejtore e Drejtorisë së Financave dhe **Izet Sadiku**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Osman Bllaca**.

**Osman Bllaca** lidhur me qëllimin e këtij takimi për diskutimin buxhetor, tha se dihet që hartimi i buxhetit për vitin 2023 rrjedh prej kornizës afatmesme buxhetore, të cilën e kemi hartuar në pjesën e parë të vitit, deri në fund të qershorit, të cilën e kemi aprovuar në Kuvendin komunal, ku dhe tash buxheti për vitin 2023 rrjedh si dokument i KAB-së. Ai në vazhdim tha se me qëllim që buxheti të jetë më i hartuar në nivelin sa më të lartë profesional, e kemi ndarë në fusha të ndryshme. Pra sot do të flasim për shëndetësinë, për nevojat dhe identifikimin e tyre për personelin, për nevojat e tyre çka kanë për vitin 2023, duke u bazuar në problemet dhe sfidat që kanë pasur gjatë vitit 2022, me qëllim që t'i eliminojmë dhe t'i përmirësojmë për vitin 2023.

Me ne sot janë të pranishëm edhe drejtoresha e Financave, Valbona Makolli, e cila merr pjesë vazhdimisht në këto dëgjime publike buxhetore, pasi që i bie barra drejtorisë së saj për ta hartuar buxhetin, po ashtu edhe drejtori i Shëndetësisë, Izet Sadiku.

Atëherë po fillojmë me diskutimin që e kemi.

Fillimisht Valbona bën një prezantim të shkurtër, një rezymë lidhje me buxhetin, i cili është paraparë deri më tani për vitin 2023.

**Valbona Makolli**, drejtore e Drejtorisë së Financave, tha se dokumenti të cilin ju kemi paraqitur janë vetëm propozimet që i kemi dhënë në Kornizën afatmesme buxhetore, pra është vetëm projekt, i cili nuk do të thotë se nuk do të ndryshojë sipas kërkesave tuaja, pasi që kërkesat e tuaja do të jenë të regjistruara në ekstrakt nga Zyra e Kuvendit.

Pra, ju sot e përfaqësoni pjesën më të ndjeshme të qytetarëve, do të thotë keni të drejtë të paraqitni kërkesat e juaja në të gjitha projektet të cilat preokupojnë lagjen apo pjesën ku jetoni.

Buxheti i Komunës së Prishtinës, së bashku me Ligjin për kryeqytetin, është 105.495.981 Euro. Këto janë të ndara në 5 kategori ekonomike, që është “paga dhe mëditje”, “mallra dhe shërbime”, “komunale”, “subvencione” dhe “investime kapitale”. “Paga dhe mëditje” janë 33 milionë, “mallra dhe shërbime” janë 27 milionë e 500 mijë, “komunale” janë 2 milionë e 700 mijë, “subvencione” janë 4 milionë e 650 mijë dhe “investime kapitale” janë 40.156.981 Euro. Janë të ndara sipas drejtorive përkatëse që ekzistojnë në Komunën tonë, po ashtu janë edhe për Drejtorinë e Shëndetësisë, në këtë material që është vetëm projekt, nuk janë të përfshira “mallra dhe shërbime”, por kërkesat e juaja mund të paraqiten edhe për mallra dhe shërbime, edhe për subvencione, edhe për komunal, që e di se keni problem edhe ju edhe ne, për shkak të rritjes jashtëzakonisht të madhe, sidomos të rrymës, dhe kjo ka reflektuar edhe në buxhetin e Komunës dhe me të gjitha fushat në të cilat ne punojmë. Për të mos iu marrë më shumë kohë, faleminderit shumë edhe njëherë, sepse e di që e keni ndarë një kohë bukur të çmueshme të punës për të na u bashkangjitur. Ne jemi këtu për t’ju dëgjuar juve për kërkesat e juaja.

**Bujar Gashi**, drejtor i QKMF-së, tha se sa i përket kërkesave tona për vitin 2023, ato kanë shkuar me kohë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe në Drejtorinë e Financave. Por, ajo çka kisha dashur të shtojë ose me qenë si kërkesë, gjë të cilën e kam diskutuar në ndërkohë me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe atë Financave, ka të bëjë me një problem që na ka shkaktuar telashe këtë vit, e që ka qenë një prej kategorive që na është hequr këtë vit. Janë paratë e imëta apo Petty Cash qysh e kanë quajtur. Normal që Petty Cash ka qenë një prej atyre pikave që i ka mbuluar problemet e përditshme që i kemi pasur e Ad- Hock që kanë rastisë, janë duke i marrë parasysht që kujdesi parësorë shëndetësorë në Prishtinë e ka në mbikëqyrje ose në kompetencë 33 institucione, e që është një numër i madh i institucioneve, dhe problemet që kanë dalë në baza ditore sa i përket shfrytëzimit të këtij fondi kanë qenë të shumta.

Ne jemi munduar gjatë këtij viti, për shkak se nuk kemi pasur të lidhim kontrata dhe që të kemi kontrata që bëhen në fund kontraktuale dhe t’i parapërgadisim për të ardhmen, që normalisht se mbetet minimalisht hapësirë për defekte të vogla, por megjithatë mendoj se një shumë sado e vogël mujore do të ishte e nevojshme për shkak se është shumë problem që të parashihet secili detaj ose secila mungesë, ose secila kërkesë që vjen prej gjithë këtyre institucioneve njësisive. Janë rreth 741 punëtorë vetëm në Qendrën e Mjekësisë Familjare, duke e përfshirë normal edhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente.

Mendoj që si pikë pavarësisht që kanë qenë rresh 1 mijë Euro, vlera 2 mijë Euro ka qenë pastaj ra në 1 mijë Euro, por ndoshta dhe një vlerë prej 500 Euro ose më pak, por vetëm që të ketë diçka në mënyrë që të kemi një pikë ku mund të mbështetemi, duke e ditur për problematikat dhe tej

zgjatjen e procedurave të prokurimit dhe shpesh herë mbesim keq për këtë pikë. Në njërin prej pikave e përmendi drejtoresha tek investimet kapitale, për shkak se mendoj se ajo është pika kyçe. Në përgjithësi në vitin 2023, në këtë kornizën afatmesme buxhetore janë paraparë 2 milionë e 330 mijë euro për kujdesin parësorë shëndetësorë, ku 1 milionë prej tyre janë për Spitalin e Prishtinës, që është i mirëseardhur. Mendoj që vetëm atëherë do ta kemi një kujdes shëndetësorë parësorë të mirëfilltë në kryeqytet. Pjesa tjetër janë 1 milionë 330 mijë, që sipas mendimit tim dhe përvojës sime, janë pak një kategori e cila është larguar dhe mendoj dhe shpresojmë që ta zgjidhim këtë vit me një pjesë të autoveturave, që është një procedurë që tani për tani është e pezulluar, po besojë që do të ritenderohet prapë, e shpresojmë që të kryhet këtë vit, mirëpo mendoj që kish me qenë mirë me qenë kategori për vitin e ardhshëm. Do me thënë me mbet që të mos kemi problem vitin e ardhshëm, që nëse nuk e kemi të planifikuar nuk mundemi fare ta hapim, e din drejtori i Shëndetësisë që e kemi shumë të rëndësishme kujdesin paliativ, është një prej premtimeve të kryetarit shërbimin kronik, e ku i kemi rreth 5 autoambulanca, nëse nuk gabo, dhe një veturë për urgjencën si kategori është dashtë me qenë tek investimet kapitale, se paku me qenë e specifikuar. Mallra dhe shërbime në njërin prej pikave ku i kemi edhe disa kategori, janë shërbime kontraktuese të tjera, ku futet edhe higjiena, janë të planifikuara rreth 600 mijë, që ka ardhur kërkesa, nuk e di sa janë të miratuara nga Kabineti i Kryetarit, sepse nuk e kam atë miratim. Janë 600 mijë euro, ku mendoj se rreth 400 mijë ose më shumë se 400 mijë shkojnë për projektin e mirëmbajtjes së higjienës e për shërbime të tjera kontraktuese do të mbesim më pak se 200 mijë euro, e që mendoj se është vlerë e vogël, ku këtu kemi me dhjetëra kontrata të cilat zhvillohen edhe nga Qendra e Mjekësisë Familjare, përkatësisht Zyra e prokurimit, me kontratat minimale që bëhen të mirëmbajtjes, servisimit, shërbime të tjera, mendoj që kësaj shume kish me qenë mirë t'i shtohen edhe 100 mijë euro për të mundur me i mbuluar edhe shërbimet e tjera kontraktuese. Ne e kemi përcjellë dhe e kemi diskutuar edhe me drejtorin e Shëndetësisë, një prej kontratave që kanë qenë ndaj furnizimeve me material administrativ shëndetësor, që ka qenë kontratë e Ministrisë së Shëndetësisë e cila këtë vit nuk na ka furnizuar fare dhe ne e kemi këtë lloj materialit vetëm edhe dy muaj rezerva, mirëpo në mungesë të fondeve dhe në mungesë të buxhetit në këtë pikë, sepse nuk ka qenë e planifikuar fare, ne jemi dakorduar që fillimisht të zhvillojmë një procedurë minimale që t'i tejkalojmë 3-4 muaj, jemi marrë vesh me drejtorin. Mirëpo mendoj që për vitin e ardhshëm shpenzimet e parapara prej njësisë së kërkesës në QKMF kapin vlerën rreth 40 mijë euro vjetore, kish qenë mirë me u paraparë si kategori tek mallrat dhe shërbimet.

**Valbona Makolli** tha se buxheti nuk është bërë ende, jemi në diskutime pa e marr feedback prej juve.

Ju faleminderit për bashkëpunim.

Propozimet e juaja i kemi pranuar qysh në fillim. Pra t'i kemi parasysh ambulancat, gjë për të cilën do të bisedojë me drejtorin që të vendoset për Petty Cash, mirëpo kemi telashe nga Ministria e Financave. Duhet të bisedojmë gjithsesi me Ministrinë e Financave për ta lëshuar Petty Cah, sepse e kemi të pamundur edhe ne këtu në Komunë me gjithë këtë staf, me gjithë këtë kërkesë e asnjë cent nuk na është lejuar.

Ajo në vazhdim tha se duhet të kemi parasysh se nëse e qesim në bashkëpunim me juve, duhet llogaritur më së largu deri në mars, për shkak të alokimit të mjeteve të vitit 2023. Pra këtë e kemi

parasysh, mirëpo në bisedim me drejtorin e plotësojmë këtë deklaratë dhe e shohim për gjashtë muaj se çka mund të bëjmë ose sa po i bie, për 8 muaj.

**Bujar Gashi**, duke iu drejtuar drejtoreshës së Financave, tha se pikërisht ky ishte shqetësimi im, se shuma të cilën mund ta qesim e kap vlera në maksimum 10 mijë euro d.m.th. nën 10 mijë euro, dhe ajo çka mund të marrim është për 3 muaj. E kam iniciuar dhe diskutuar me drejtorin, që vlera me qenë më e madhe dhe të zhvillohet në Komunë e jo tek ne, për me mundur me kaluar në mars apo prill, se e kam parasysh kur mundet me filluar buxheti.

Pra, atëherë unë po e pezulloj përkohësisht atje, sepse ju kam thënë po e pezulloj derisa të shohim nëse mund të bëjmë diçka, po nuk është problem, atë shumë vjetore që ne e kemi paraparë ne nuk

po e bëjmë, sepse unë kam planifikuar kornizë, me qenë do me thënë kontratë kornizë që mos të merremi çdo vjet me këtë kontratë. Ne mundemi ndoshta të merremi vesh në njëfarë forme që me pasur për këtë vit me qenë një shumë më e vogël, kur të bëhet disponueshmëria në vitin tjetër me e fut në buxhet, me e planifikuar dhe me qenë vlera reale për vitin 2024 .

**Arbër Vokri**, asamblist i Kuvendit komunal, tha se në mbledhjen e parafundit të Kuvendit kur është diskutuar për buxhetin, kam çekur që 7 milionë euro për shëndetësi janë pak, d.m.th. edhe sikur mos ta kishim pasur parasysh këtë inflacion që është duke ndodhur me hov të shtuar vitin e fundit.

Besoj se i kujtohet edhe dr. Bujarit, edhe kolegëve të tjerë, të cilët kanë qenë më herët, e kam përmendur se 7 milionë për Drejtorinë e Shëndetësisë janë pak, kështu që mendoj se nevojat kanë qenë së paku me qenë në hap me inflacionin, pra të jenë 10 milionë. Mirëpo nëse i kishim shikuar nevojat reale, duhet të shkojë deri në 20 milionë ky buxhet, se mendoj që është vetëm 1/3 e asaj që është e nevojshme, sepse nëse ishte bërë një krahasim me vëllimin e punës se sa shërbime ofrohen prej një punëtori shëndetësor në Prishtinë dhe sa prej një punëtori në komunat e tjera, del se vëllimi i punës dhe ofrimi i shërbimeve ndaj pacientëve është më i madh në Prishtinë, pasi që duke qenë kryeqytet, këtu vijnë edhe prej komunave të tjera.

Një ndër kërkesat është edhe kërkesa për dy ambulanca të Mjekësisë Familjare, njëra në Koliq nëse ka mundësi me u parapa diku në buxhet për t'u rindërtuar, do me thënë me u bë prej fillimit në Koliq kurse tjetra në Keqekollë, nëse ka mundësi të sigurohet një mirëmbajtje e vazhdueshme. Pastaj sigurimi me stetoskopët, sminonangometrat e pulsoksimetrat etj, që është duke na ndodhur. E kam edhe një kërkesë prej kolegëve që kish me qenë e mirëpritur, nëse ka mundësi të sigurohen edhe uniformat.

Një ndër kërkesat e tjera është edhe shtimi i personelit shëndetësor, i cili do duhej të ishte një prej prioriteteve, mirëpo kjo ka implikime financiare, d.m.th. tash disa prej pikave që mundohemi me i sjell këtu munden mos me qenë drejtpërdrejt kompetencë e Komunës, por nivelit qendror, pra e Ministrisë së Financave. Po që se Ministria e Financave nuk do ta lejonte një shtim të linjave

buxhetore për personel të ri, atëherë do duhej të shikohej mundësia për ndonjë partneritet publiko - privat, qysh kishte me u zvogëluar ngarkesa e vëllimit të punës që e kanë punonjësit shëndetësorë në Prishtinë.

**Valbona Makolli** tha se problemi është tek Ministria e Financave, që këtë herë kemi marr pjesë direkt si Komunë e Prishtinës dhe jemi përzgjedhur në ndarjen e grandeve. Granti i Shëndetësisë është jo i vogël, por minimal, edhe më shumë se gjysma e stafit shëndetësorë paguhen me grantin e përgjithshëm të Komunës, grantin e Administratës. Problemi që e kam njoftuar edhe në Kuvend, është se numri i regjistrimit të popullsisë, që është 198 mijë dhe pa të formulën nuk e prish Ministria e Financave për asnjë Komunë, e më së paku për Komunë e Prishtinës që ka shumë dhe ndërrojnë. Për pagesat e natës duhet të diskutojmë, të bëhet ashtu si e parasheh ligji, nuk e di ndoshta edhe drejtori më ndihmon. Furnizimi me barna dhe me uniforma, këto kanë qenë të bllokuara në OSHP për më shumë se 1 vit e 2-3 muaj. OSHP-ja nuk ka qenë funksionale, tash veç ka dhënë dritën e gjelbër, por edhe ata duhet t'i mirëkuptojmë sepse kanë shumë lëndë që nuk janë vetëm të Prishtinës. Veç të Prishtinës janë diku 22-23 milionë që janë në pritje, kanë filluar por është duke shkuar procesi shumë ngadalë, sepse nuk mund t'i japin përparësi vetëm një komune ose vetëm një Ministrie, por këto momentin që bëhen përveç që janë kontrata që duhet të bëhen çdo vjet, sepse çdo vjet ka nevojë për uniforma, për mjete të mjekësisë dhe për barna, tash sigurisht se do të fillojë edhe zbatimi i saj se veç është nënshkruar.

**Arbër Vokri** u shpreh, më lejoni ta them një ide dhe sugjerim sepse ishte prej të parave që ma kanë jap disa kolegë po që më iki prej mendjes certifikatat e vlerësimit mjekësorë që bëhen për punë, për vozitje konkretisht për kamion 50 euro ish një për herën e parë kur jepet për kamionë me vozit. Këto tjerat certifikata për adoptim mjekësor e kam fjalën, për adoptim ish 50 euro një kështu një numër i madh i llojeve të certifikatave mjekësore që jepen bëhen kryesisht në sektorin privat dhe ndoshta me e shikuar mundësinë që me e marr autorizimin sektori publik. Të kryhen në Qendrën e Mjekësisë Familjare mbase edhe të kontraktohen për këto të cilat janë të nivelit specialistik, me specialist por shuma që kish me u mbledh prej tyre është qindra, mijëra euro nëse e merr autorizimin sektori publik, faleminderit.

**Bujar Gashi**, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Vokri, tha se QKMF-ja ofron këtë shërbim Arbër, ofron një shërbim parcial, që është certifikata shëndetësore fizike, nuk është psiko-fizike, por si certifikatë për të pasur të drejtë ose për t'u pranuar prej institucioneve të tjera ose çfarëdo qoftë, duhet të kërkohet certifikatë psiko-fizike. Kujdesi parësorë shëndetësorë në bazë të udhëzimit administrativ 08/2017 dhe 04/2020 nuk kemi psikiatër, nuk kemi neurolog, do me thënë është i paplotësuar komisioni i cili mund të jap si certifikatë, do të ishte e mirëseardhur por fatkeqësisht ligji nuk na e lejon me e pasur të tillë dhe jemi të detyruar të lëshojmë vetëm certifikatë fizike, e cila ju kryen punë ose shërben për punësim.

Do të thotë, se ajo bëhet në baza ditore dhe lëshohet një numër i caktuar i tyre e që çmimi është 15 Euro në bazë të udhëzimit administrativ 04/2007 që është udhëzimi për bashkëpagesa në nivel të Republikës e që e rregullon çështjen e bashkëpagesave në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.

Për t'u ndërlidhur edhe me pikën tjetër për pagesën simbolike të ndërrimit të natës, ne e dimë që në bazë të Ligjit për shërbimet emergjente janë të papagueshme, nuk paguhen, mirëpo pagesat për rastet jo emergjente pa asnjë problem mund të paguhen në bazë të këtij udhëzimi dhe listës që e kemi secila qendër në institucionet tuaja se për cilat raste mund të bëhen ato pagesa simbolike dhe për cilat jo dhe kush lirohet prej pagesës.

**Izet Sadiku**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, shprehu mendimin se gjërat që u thanë këtu, një pjesë besoj që Arbëri i dinë do me thënë, por për t'i diskutuar prapë, që janë shqetësim, po flasim për sektorin e shëndetësisë, sidomos numri i vogël i të punësuarve, ne e kemi 99-shin dhe për vitin e ardhshëm është 0 te Prishtina dhe qe disa vjet vazhdon ta ketë zero dhe të gjithë e dimë se Prishtina ka numër më të madh të banorëve se 198 mijë.

Sa i përket furnizimit, ju e dini, vetëm po e konstatojmë, do me thënë furnizimi me barna për institucione është e drejtë që e mbanë Ministria, edhe tash diskutimin që e kemi pasur me ta shpesh deklarohen që po mendojnë se është mirë t'u japin të gjitha komunave edhe buxhetin për barna, për arsye se ne në këta 6 muajt e parë të vitit diku 40% shkon në furnizim me barna dhe pjesën tjetër pastaj ne duhet ta mbulojmë vetë. E keqja që po dua ta sqaroj këtu është që ti e ke për obligim deri në 5 muajt në vijim me e prit Ministrinë, nëse Ministria nuk e mbulon deri me më 5, ti duhet të fillosh vet të planifikosh, të bësh për atë muaj, që është goxha vështirë brenda 1 muaji cilat po mungojnë krejt me i furnizuar. Ne e kemi një kontratë fatbardhësisht, me disa probleme e kemi nënshkruar kontratën për 3 vjet, i kemi 180 mijë euro, është për 1 vit, për 3 vite është 480 mijë euro, është kontrata, dhe e kemi nënshkruar 160 mijë, në fakt vjetoren kemi nënshkruar dhe kemi bërë furnizimin vetëm prej saj.

Ai në vazhdim bëri të ditur se ka biseduar me Ministrinë, Ministria nuk është duke bërë fare furnizim, për shkak të ngritjes së çmimeve me infuzione. Për shkak të rritjes së çmimit, ata kanë një kontratë që ish 2,50 Euro apo nuk e di qysh i infuzionit, nuk e di sa është mos ta marr sa jo 0.30 centë, jo me 0.50 centë, tash as me 0.50 centë nuk po na ofrojnë më, tash kanë mbetur peng i asaj kontrate sikur shumë kontrata të tjera, kështu që këto janë sfida. Unë mendoj që Prishtina po kalon në fazë tranzitore në shëndetësi. Ju e dini se ne jemi duke kaluar edhe në fazën ku ne po mundohemi të fillojmë zbatimin e Ligjit për kryeqytetin, që parasheh edhe krijimin e mjekësisë sekondare. Kjo është një sfidë dhe unë mendoj, këtu është edhe nënkryetari, mundet me na ndihmuar, ne jemi duke diskutuar për buxhet dhe nuk reflekton, kjo nuk është reformë për shëndetësi në Prishtinë, me këtë buxhet prej 1 milionë e 100 me i dhënë 1 milionë 2 300 nuk është reformë. Ne mund ta mbulojmë kështu, prapë jemi mbuluar, por në qoftë se ti do t'i fillosh institucionet sekondare, në qoftë se do ta bësh shëndetësinë primare në Prishtinë, ne duhet ta rrisim buxhetin. E dimë që ka kërkesa në tjera fusha, ne do të fillojmë të diskutojmë prapë edhe njëherë, bile për disa fusha që u përmenden këtu me e rritur buxhetin për arsye se ky buxhet veç rritjet inflacioni që është, ti faktikisht kur ta marrësh në krahasim me këtë vite ose barabartë me këtë vit, kontratat që i kemi ne sot të nënshkruara nga 15% ose 20% nëse rriten, ty të bie ai buxhet. Kështu që do ta bisedojmë këtë reformë, për arsye se unë mendoj që një reformë e mirëfilltë në shëndetësi në Prishtinë, do të jap impakt në reformën në shëndetësisë në Kosovë, për arsye se Prishtina është kjo, ku së paku rreth 30% e qytetarëve të Kosovës jetojnë në Prishtinë.

**Esat Halili**, zv. drejtor i QKMF-së, tha se në prezantimin e dr. Arbërit u përmend një çështje e cila më shtini të mendoj për partnerin publiko-privat, duke e parë që po kemi sfidë do me thënë në ngritjen e numrit të punëtorëve shëndetësorë dhe duke u bazuar nga përvoja e shteteve të perëndimit, ku kontraktohen shërbime shëndetësore private, duke e nisur edhe qendrën intensive mund të jepet privat. Po e jap si shembull shërbimin kronik, i cili me ardhjen e drejtorit është fuqizuar dhe është rritur numri i shërbimeve, por të njëjtën kohë është edhe sfida me staf. Desha të ju pyes në përgjithësi të gjithëve, se cilat janë mundësitë që në të ardhmen ky shërbim të kontraktohet me një institucion të licencuar shëndetësor në Republikën e Kosovës dhe ne të blejmë shërbime prej atij institucioni, për arsye se nuk po mundemi ta rrisim numrin e stafit sikurse me kompanitë e sigurimit dhe higjienës.

**Izet Sadiku** shprehu besimin se është e lejuar në aspektin ligjor, sepse në Kosovë Ministria e Financave e lejon do me thënë partnerin publiko-privat, në aspektin praktik sa është në fushën e shëndetësisë, ne nuk kemi në Kosovë asnjë rast të tillë që ka filluar. Sigurisht që do të duhej të fillonte, edhe pse ne aty kemi filluar, sidomos rajoni nuk ka dhënë shembuj të mirë. Unë e di që kur kam qenë zv. ministër ka qenë njëfarë kontrate që ka furnizuar për sterilizimin e këtyre pajisjeve mjekësore. Shqipëria e ka dhënë krejt privat, por ka dalë nja 10 herë më e shtrenjte që e ka bërë vet shteti dhe tash është nëpër hetime ajo kontratë.

Kështu që këtë Arbri që e tha unë pajtohem që mund të jetë qysh thoni ju, sikur për sigurinë dhe higjienën, por problemi ka qenë ky numri i vogël i stafit, ti ishte dashur që disa shërbime me i kthyer në privat, përndryshe me i kthyer ne edhe ata brenda duhet t'i heqim edhe gjysmën e punëtorëve shëndetësorë.

**Bujar Gashi**, duke u ndërlidhur me diskutimin, tha se lidhur me këtë në muajt e fundit kemi diskutuar me dr. Rrezin dhe me drejtorin, që nga muaji janar me drejtorin dhe në takimet me Ministrinë dhe grupe të veçanta, e kemi një buxhet që vjen enkas, do me thënë është 108 mijë euro në vit për shërbime kualitative, e që është në kuadër të mallrave dhe shërbimeve. Mendoj që në aspektin ligjor mund të bëhet përmes prokurimit publik, do me thënë që të kontraktohen shërbime të tilla, vetëm se duhet të analizohet aspekti ligjor i saj, e më mira kisha me thënë aspekti se si do të funksionojë ose se si do të implementohet dhe si do të mbikëqyret. Do me thënë ajo ka me qenë më shumë sfidë sesa me u realizuar si shërbim. Mirëpo mendoj që buxhet ka, sepse është i ndarë ekstra për kujdesin paliativ nga Ministria e Shëndetësisë. Bashkë me drejtorin tash kemi arritur që të kemi edhe një fond tjetër, që është prej 577 mijë eurove në vit për shëndetin e nënës dhe fëmijës, do me thënë që do të implementohet prej vitit 2023, dhe ne jemi zotuar që gradualisht do të arrijmë ta implementojmë, ndoshta jo nga janari por duke filluar duke u zgjeruar për shkak të mungesës së stafit. Mirëpo atë buxhet ne duhet ta dimë qysh ta shfrytëzojmë, sepse buxheti për mallra dhe shërbime nuk është buxhet që mundesh ta rritësh stafin, por mundesh me kontraktuar staf, mundesh me kontraktuar shërbime. Unë e di që çështja e rritjes së numrit me kontrata ose me kushte

specifike është si gjetje e auditorit dhe si e tillë mendoj që ndër vite ka shkaktuar probleme të jashtëzakonshme, e që nuk e di a do mund të funksionoj në vitin 2023, por që kish me qenë zgjidhje se e ke kategorinë specifike prej ku mundesh me pagua. Atëherë duhet vetëm me e gjetur mënyrën nëse mundemi me kontraktuar si shërbime pse jo mos me u kontraktuar, sepse ky staf që ekziston për t'u marrë me problematikat në vitin 2023, veç do ta ngulfat shëndetësinë primare, sepse e kemi diskutuar me dhjetëra herë, është e pamundshme, por i kemi 577 edhe 108, do me thënë që po i bie rreth 700 mijë euro që i kemi për këto dy kategori, që në vitin 2023 do të jenë në buxhetin e shëndetësisë si specifik për këto dy çështje.

**Izet Sadiku** lidhur me diskutimin e dr. Bujarit, tha se në çoftë se nuk gjejmë punë specifike për të angazhuar njerëz, nuk mund t'i harxhojmë ato para, pasi që nuk ka diçka specifike.

**Valbona Makolli** tha se për shkak të mungesës së analizës si do të funksionojë ajo, pasi që kur të bëhet buxheti ato duhet të specifikohen.

Pra çka do të bëni me to në çoftë se nuk e keni një analizë për shkaqe të ndryshme të stafit ose mjeteve teknike.

Prandaj mendoj se më mirë është t'i shpërndajmë në shpenzime të barnave, sepse nëse nuk realizohen nuk mund t'i bartim.

**Bujar Gashi** tha se unë e kam hallin që këto mjete mos me u kthye, sepse kemi nevojë ekstreme. U përmenden se nuk kemi nevojë të specifikohen, sepse kemi takime të përditshme me drejtorin, ku po na nxehet kryet e nuk po dimë ku të marrim e ku të furnizohemi, sepse dr. Arbëri punon edhe vetë ne jemi mjek, jemi pjesë e punës e i dimë sfidat. Aq sa kemi kapacitet kemi ble stetoskopa, aq sa kemi tensiometra, por jo për të gjithë ka pasur, p.sh. sepse duke e marr parasysh kualitetin e tyre ndoshta edhe ka pasur njëherë për krejt, por më shumë se dy javë që ka ardhur një pulsoksimetër nuk besoj që i ka qëndruar në 10 matje, është prishur.

Për këtë po të them tek mallrat dhe shërbimet, në këtë kategori nëse janë specifike a kemi me pas hapësirën për t'i shfrytëzuar për çështje të tjera, së paku të mos kthehen. Nëse do të duhej një analizë, një projekt, ne brenda muajit e realizojmë dhe e dërgojmë si projekt si QKMF, se qysh do t'i zbatojmë një kujdes paliativ për t'i shfrytëzuar ato mjete, qoftë përmes një kontrate, përmes një kompanie, për t'u tenderuar ose çfarëdo forme. Projektin e bëjmë, projektin ideor pa asnjë problem mund ta dorëzojmë, por veç me definua se qysh po duam t'i shfrytëzojmë këto mjete.

E që mos të vjen 2023, marsi, kur alokohen mjetet e ne atëherë të ja nisim të mendojmë se qysh t'i shfrytëzojmë mjetet, unë mendoj se tash duhet të mendojmë si t'i shfrytëzojmë. Ato kanë me qenë, ne kemi marr garanci prej Ministrisë, bashkë me drejtorin, që këto mjete janë të garantuara dhe kanë me dalë, sepse në parim e kemi nënshkruar një marrëveshje dhe jemi zotuar që do ta bëjmë si projekt. Na kanë premtuar që do të na japin edhe pak staf, do na rrisin pak numrin, sepse i ka 199 numra Ministria e Shëndetësisë që i ka bërë për këtë projekt e që ne kemi lobuar shumë me drejtorin që me mund së paku edhe Prishtinës me i dhënë, edhe pse në bazë të asaj qysh është nxjerrë, në bazë të numrit të banorëve ne jemi zero, do me thënë ashtu e kemi prej Ministrisë së Financave.



**Osman Bllaca** tha se meqë nuk kemi diskutues të tjerë dhe nuk kemi komente të tjera për të trajtuar, atëherë e përfundojmë diskutimin dhe ju falënderojmë për pjesëmarrje, gjegjësisht për këto propozime shumë konkrete të cilat i ofruat. ju faleminderit e mirupafshim.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:00.*

**Procesmbajtësja**  
**Lendita Spahija**

Pjesëmarrja në diskutime publik lidhur me Planifikimin e buxhetit të vitit 2023,

më 10.08.2022.

	Emri dhe Mbiemri	Gjinia M/F	E-mail	Nënshkrimi
1	Myrvete Sopi - Dibrani	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]
2	Medyze Krasniqi			
3	Arbër Vokri			
4	Esat Rexhi			
5	Dunora Cakshiti			
6	Fatmirida Hoxhi			
7	Gjylgje Sherifi			
8	Florie Hoxheni Morina			
9	Adrenete Alija			
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				